



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËSISË

Akte të konferencës shkencore

**AUDITORËT UNIVERSITARË TË
ALBANOLOGJISË – PËR KRIJIMIN
E NJË RRJETI NDËRKOMBËTAR TË
QENDRAVE DHE TË KATEDRAVE
TË GJUHËS SHQIPE**

2025



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

DEPARTAMENTI I GJUHËSISË

Akte të konferencës shkencore

**AUDITORËT UNIVERSITARË TË ALBANOLOGJISË -
PËR KRIJIMIN E NJË RRJETI NDËRKOMBËTAR
TË QENDRAVE DHE TË KATEDRAVE TË GJUHËS SHQIPE**

2025

ANXHELA LEPURI

Universiteti i Tiranës

GIUSEPPINA TURANO

Università Ca' Foscari, Venezia

SHQIPJA NË VENEZIA: GJUHË, IDENTITET DHE TRASHËGIMI NË UNIVERSITETIN CA' FOSCARI

Abstrakt

Ky studim shqyrton lidhjet historike të shqiptarëve me Venecian – nga prania mesjetare, institucionet komunitare si *Scuola degli Albanesi* dhe figurat e shquara (Barleti, Tomeu), deri te roli i diasporës së sotme në rajonin e Venetos – dhe i vë ato në dialog me sfidat bashkëkohore të ruajtjes së gjuhës shqipe në Itali. Së pari analizohet kuadri ligjor italian për pakicat gjuhësore dhe pozicionimi i shqipes si gjuhë e emigracionit të vonshëm. Më pas fokusi zhvendoset te Universiteti Ca' Foscari, ku shqipja mësohet si gjuhë e huaj dhe si gjuhë e trashëgimisë, dhe ku pikërisht ky universitet shërben si hapësirë kyçe për forcimin e kompetencës gjuhësore dhe për ruajtjen e identitetit kulturor të diasporës shqiptare.

Fjalë kyç: *shqipja, identiteti, dygjuhësia, trashëgimia kulturore, integrimi kulturor.*

Hyrje

Shqipëria ka një histori të gjatë dhe të rëndësishme marrëdhëniesh me Republikën e Venedikut, e cila nis që në Mesjetë dhe vazhdon edhe në periudhat e mëvonshme. Republika e Venedikut, një nga fuqitë kryesore tregtare dhe detare të Mesdheut Lindor, zhvilloi marrëdhënie të ngushta

me qytet-portet shqiptare, si Durrësi, Shkodra dhe Vlora. Në shekullin XV, disa territore shqiptare ranë nën ndikimin ose kontrollin venedikas, veçanërisht pas dobësimit të përkohshëm të Perandorisë Osmane. Ndër viti 1396 deri në 1479. Gjatë kësaj periudhe, shumë shqiptarë u vendosën në Venecia për arsye tregtare, ushtarake ose për të kërkuar mbrojtje nga kërcënimi osman. Pas rënies së Shkodrës në vitin 1479, një valë e re refugjatësh shqiptarë u largua drejt territoreve venedikase, përfshirë edhe vetë qytetin e Venecias. Shqiptarët luajtën një rol të rëndësishëm në jetën ekonomike dhe shoqërore të qytetit, duke kontribuar në fushat e tregtisë, e zejtarisë dhe të shërbimeve ushtarake. Një pjesë e tyre arriti të integrohej në strukturat politike dhe shoqërore të Venedikut, duke forcuar më tej lidhjet ndërmjet komuniteteve shqiptare dhe venedikase.

Në vazhden e këtij integrimi të qëndrueshëm në jetën ekonomike dhe shoqërore të qytetit, një aspekt veçanërisht i rëndësishëm i pranisë shqiptare në Venecia ishte krijimi i institucioneve që synonin mbrojtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre komunitar. Ndër më të rëndësishmet ishte “Scuola degli Albanesi” (Shkolla e Shqiptarëve), e themeluar në shekullin XV si një shoqatë me karakter fetar dhe kulturor. Megjithëse nuk funksiononte si institucion arsimor në kuptimin tradicional, kjo shkollë vepronte si një organizatë fetare dhe shoqërore e përqendruar në ruajtjen e identitetit kulturor dhe fetar të shqiptarëve të vendosur në Republikën e Venedikut. Sipas studiueses Lucia Nadin (2008), “Scuola degli Albanesi” shërbente si një qendër ku shqiptarët e Venecias mblidheshin për të mbështetur njëri-tjetrin dhe për të ruajtur lidhjen me atdheun e tyre. Ky institucion luajti një rol të rëndësishëm në forcimin e solidaritetit të brendshëm, në ruajtjen e traditave dhe në afirmimin e pranisë shqiptare në një prej qendrave më të mëdha tregtare, kulturore dhe politike të Mesjetës së vonë.

Një tjetër dëshmi e rëndësishme e aktivitetit kulturor të komunitetit shqiptar në Venecia e që ndërlidhet me trashëgiminë artistike të “Scuola degli Albanesi”, janë veprat e piktorit të shquar Vittore Carpaccio, artist i Rilindjes venedikase, për të cilin mendohet se qe me origjinë shqiptare. Pikturat e tij, të cilat paraqesin skena nga jeta e Shën Gjon Pagëzorit dhe e Shën Jeronimit, përbëjnë jo vetëm vepra me vlerë të lartë artistike, por edhe dokumente simbolike të identitetit komunitar.

Një figurë tjetër e shquar është edhe Marin Barleti, prifti dhe historiani

nga Shkodra, i cili, pas rënies së qytetit në vitin 1479, u vendos në Venecia ku kaloi një pjesë të jetës së tij krijuese. Barleti e botoi veprën e vet monumentale "Historia e Skënderbeut" në Venecia në vitin 1504. Kjo vepër jo vetëm përjetësoi figurën e heroit kombëtar shqiptar, por u bë edhe një nga tekstet kryesore që ndikuan në përhapjen e njohurive rreth historisë dhe kulturës shqiptare në mbarë Evropën. Një tjetër personalitet i spikatur ishte Nikollë Leonik Tomeu, filozof dhe humanist me prejardhje shqiptare, i cili dha një kontribut të çmuar në qendrat kryesore akademike italiane, përfshirë Venecian dhe Padovën. Mësimdhënia dhe veprimtaria e tij intelektuale luajtën një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e ideve të Rilindjes Evropiane, duke e bërë atë një urë lidhëse ndërmjet kulturës shqiptare dhe humanizmit perëndimor.

Shqiptarët gëzonin reputacion të lartë për zotësinë e tyre në fushën e luftës dhe shpesh rekrutoheshin nga Republika e Venedikut si trupa të specializuara ushtarake. Ata shërbenin si pjesë e marinës venedikase, duke u bërë element i rëndësishëm në ruajtjen e sigurisë dhe në realizimin e synimeve politike e ushtarake të Republikës në Adriatik dhe më gjerë. Në planin ekonomik, prania e tyre rezultoi po aq vendimtare. Shqiptarët luanin rolin e ndërmjetësve të aftë në tregtinë mes Venedikut dhe krahinave ballkanike, duke përfituar nga njohja e gjuhëve, e zakoneve dhe e udhëve tregtare të rajonit. Falë tyre, qarkullimi i mallrave mes qytetit venedikas dhe territoreve shqiptare u zhvillua me ritme më të shpejta dhe me efikasitet më të madh, gjë që përforcoi lidhjet ekonomike e politike të Republikës me brigjet e Adriatikut lindor. Këto ndërveprime të shumanshme jo vetëm që ndikuan në prosperitetin e Venedikut, por edhe u dhanë shqiptarëve hapësira të reja për të ruajtur dhe integruar traditat e tyre brenda një mjedisi qytetëruar shumë më të gjerë, karakteristik për botën mesjetare të Mesdheut.

Gjurmët e komunitetit shqiptar në Venecia vazhdojnë të jenë të pranishme edhe sot, të reflektuara në toponiminë e qytetit, në ndërtesa historike dhe në trashëgiminë artistike e kulturore që ka mbërritur deri në ditët tona. Kontribut i veçantë në studimin e këtyre lidhjeve shekullore i përket historianes italiane Lucia Nadin, një prej studiuesve më të rëndësishme të marrëdhënieve shqiptaro-venedikase. Ajo ka thelluar kërkimet mbi emigracionin shqiptar në Venecia dhe rolin që ky komunitet ka luajtur në jetën kulturore, ekonomike dhe shoqërore të qytetit. Nadin ka vënë në dukje vlerën e jashtëzakonshme të arkivave venedikase, sidomos

atë të dokumentacionit të ruajtur në Bibliotekën Marciana.

Edhe në ditët e sotme, prania shqiptare në Venecia dhe në të gjithë rajonin e Venetos mbetet një pjesë e dukshme dhe e çmuar e peizazhit kulturor e shoqëror të zonës. Megjithëse të integruar natyrshëm në jetën urbane dhe institucionale të qytetit, shumë prej tyre vijojnë të ruajnë gjuhën, zakonet dhe elementet e trashëgimisë së tyre kulturore. Komuniteti shqiptar i sotëm në Venecia përfaqëson një model të harmonisë ndërkulturore, duke dëshmuar se bashkëjetesa e traditave të ndryshme mund të sjellë vlera të reja si për shoqërinë vendase, ashtu edhe për ruajtjen e identitetit të origjinës.

Mbi kuadrin ligjor italian për pakicat gjuhësore

Duke pasur parasysh vazhdimësinë historike të komunitetit shqiptar në Venecia dhe rolin e tij në ndërthurjen kulturore mes dy popujve, çështjet e identitetit, të gjuhës dhe të trashëgimisë kulturore marrin një rëndësi të veçantë edhe sot. Në këtë kuptim, për të kuptuar më mirë pozicionin e komunitetit shqiptar në Itali dhe sfidat që lidhen me ruajtjen e gjuhës dhe të traditave, është e nevojshme të ndalemi shkurtimisht edhe te kuadri ligjor italian që rregullon të drejtat e pakicave gjuhësore. Së pari, duhet theksuar se gjuhët e trashëgimisë (*heritage language*) janë ato gjuhë të komuniteteve kulturore dhe etnogjuhësore që zhvillohen në kushte dygjuhësie ose shumëgjuhësie, ku një gjuhë tjetër ka status shoqëror dhe institucional më të lartë. Folësit e këtyre gjuhëve janë zakonisht pjesëtarë të një pakice gjuhësore që, krahas gjuhës së tyre amtare, pra gjuhës së trashëgimisë, janë të ekspozuar edhe ndaj gjuhës zyrtare të shtetit ku jetojnë, e cila dominon në jetën publike dhe institucionale (Montrul, 2006:13). Ruajtja e një gjuhe të trashëgimisë përfaqëson një proces të shumëanshëm, i cili ndikohet nga një sërë faktorësh që ndërveprojnë mes tyre. Ndër përbërësit më të rëndësishëm renditen niveli i kompetencës gjuhësore, shkalla e përdorimit të gjuhës në situata të ndryshme, qëndrimet dhe vlerësimet që folësit kanë ndaj saj, si dhe lidhjet e tyre identitare, si në aspektin kulturor, ashtu edhe në atë gjuhësor (Montrul, 2006). Po ashtu, mosha e folësve, kohëzgjatja e qëndrimit në vendin pritës dhe përmasat e komunitetit luajnë një rol të qenësishëm në këtë dinamikë.

Italia disponon një kornizë ligjore të mirëpërcaktuar për mbrojtjen

e pakicave gjuhësore, e cila buron nga vetë Kushtetuta e Republikës. Neni 6 i saj thekson qartë detyrimin e shtetit për të garantuar mbrojtjen e minoriteteve gjuhësore përmes masave të posaçme. Në zbatim të këtij parimi kushtetues, akti më i rëndësishëm normativ është Ligji nr. 482/1999, i njohur si ligji për “mbrojtjen e minoriteteve historike gjuhësore”. Ky ligj njih zyrarisht dymbëdhjetë komunitete gjuhësore autoktone - midis të cilëve arbëreshët, sllovenët, gjermanët, dhe grekët - duke synuar ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë së tyre kulturore. Ligji 482/1999 parashikon masa që lehtësojnë përdorimin e gjuhëve të këtyre pakicave në administratën publike, në institucionet arsimore dhe në mediat lokale, si dhe mbështet projekte kulturore e fonde të dedikuara për të forcuar rolin e tyre në jetën shoqërore. Përmes këtyre dispozitave, ai synon të krijojë një mjedis ku diversiteti gjuhësor dhe kulturor të konsiderohet një pasuri që duhet ruajtur dhe zhvilluar. Megjithatë, pavarësisht këtij kuadri të qëndrueshëm, legjislacioni paraqet kufizime të dukshme kur bëhet fjalë për gjuhët e komuniteteve të ardhura nga migracioni bashkëkohor. Shqiptarët e Italisë, të cilët nuk bëjnë pjesë në pakicat historike të parashikuara nga ligji, nuk përfitojnë mbështetje specifike për ruajtjen e gjuhës së tyre amtare. Si rrjedhojë, shqipja si gjuhë e trashëgimisë nuk gëzon të njëjtat mekanizma mbrojtjeje si komunitetet e vjetra gjuhësore, duke e bërë ruajtjen dhe transmetimin e saj ndër breza një sfidë të vazhdueshme në kushtet e integritetit dhe të presionit të gjuhës dominuese.

Për shkak të mungesës së politikave të mirëstrukturuara që synojnë mbështetjen e gjuhëve të trashëgimisë të lidhura me emigracionin e kohëve të fundit, shqipja në Itali shpesh trajtohet në mënyrë të përgjithshme si një gjuhë e huaj. Në shumicën e rasteve, mbijetesa dhe transmetimi i saj ndër breza varet nga angazhimi i vetë komunitetit dhe nga përpjekjet individuale të familjeve shqiptare. Megjithatë, edhe në mungesë të një kuadri specifik ligjor, ekzistojnë disa mekanizma dhe mundësi që, ndonëse indirekt, mund të ndihmojnë në ruajtjen dhe promovimin e gjuhës shqipe. Përmendim këtu dekretin legjislativ për integritetin (D.Lgs. 286/1998), i cili synon të lehtësojë përfshirjen shoqërore dhe kulturore të emigrantëve dhe të familjeve të tyre në jetën italiane. Ndër parimet që ai promovon është edhe respektimi i identitetit kulturor të komuniteteve të ardhura, çka reflektohet veçanërisht në fushën e arsimit dhe të aktiviteteve publike. Edhe pse dokumenti nuk i përmend në mënyrë të drejtpërdrejtë gjuhët e trashëgimisë, ai krijon një kornizë të favorshme për nisma që mbështesin

mësimin dhe përdorimin e gjuhëve amtare të fëmijëve të emigrantëve. Kështu, brenda hapësirave që ky dekret lejon, shkollat dhe institucionet lokale mund të zhvillojnë projekte që ndihmojnë në ruajtjen e shqipes si pjesë e identitetit të komunitetit shqiptar në Itali. Po ashtu edhe dekreti mbi arsimin ndërkulturor (CM nr. 73/1994), u jep shkollave italiane një rol aktiv në ndërtimin e një mjedisi arsimor që pasqyron shumëllojshmërinë kulturore të nxënësve. Ai i inkurajon institucionet arsimore të hartojnë projekte dhe praktika që promovojnë dialogun ndërkulturor, duke u dhënë hapësirë gjuhëve dhe traditave të komuniteteve me prejardhje të ndryshme. Në këtë kuadër, shumë shkolla zgjedhin të organizojnë veprimtari që përfshijnë edhe gjuhët amtare të fëmijëve emigrantë; shqipja, në këtë proces, gjen herë pas here vendin e saj si pjesë e një qasjeje që synon njohjen dhe vlerësimin e identiteteve të shumëfishta të nxënësve.

Në disa institucione arsimore, falë angazhimit të prindërve dhe të vetë komunitetit shqiptar, janë zhvilluar kurse plotësuese apo veprimtari kulturore që synojnë mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e traditave shqiptare. Këto nisma shpesh mbështeten nga bashkitë, organizatat joqeveritare ose vetë komunitetet lokale, duke u mbështetur kryesisht në punën vullnetare dhe në projekte të kufizuara në kohë. Paralelisht, në disa shkolla është inkurajuar përdorimi i gjuhëve të trashëgimisë si mjete mbështetëse në procesin didaktik: mësuesit i kanë integruar ato në aktivitetet e klasës, për të krijuar një atmosferë më gjithëpërfshirëse dhe ndërkulturore. Këtij kuadri i shtohen edhe shkollat e gjuhës shqipe që funksionojnë në Itali, të cilat vitet e fundit janë bërë një realitet gjithnjë e më i qëndrueshëm. Kontribut të rëndësishëm në forcimin e tyre ka dhënë edhe Qendra e Botimeve për Diasporën, e cila ka nisur t'i pajisë këto shkolla me tekste mësimore, mjete didaktike dhe materiale të përshtatura për fëmijët shqiptarë që rriten në një mjedis dygjuhësh. Këto burime të reja ndihmojnë jo vetëm në organizimin e mësimin të strukturuar të shqipes, por edhe në ruajtjen e lidhjes kulturore të brezave të rinj me vendin e origjinës. Megjithatë, pavarësisht progresit të bërë, mbetet e nevojshme një qasje më e sistematizuar dhe një përfshirje më e gjerë institucionale. Shpesh, këto iniciativa mbështeten kryesisht në vullnetin e prindërve dhe të mësuesve të angazhuar, gjë që i bën ato të brishta dhe të varura nga rrethanat lokale. Për këtë arsye, një strategji më afatgjatë - qoftë nga autoritetet shqiptare, qoftë nga ato italiane - do të ishte thelbësore për të garantuar që mësimi i gjuhës shqipe të mos mbetet vetëm një përpjekje sporadike, por të kthehet

në një praktikë të qëndrueshme që përfiton një mbështetje profesionale, financiare dhe institucionale të vazhdueshme.

Mësimi i gjuhës shqipe në Universitetin Ca' Foscari të Venecias

Në Universitetin Ca' Foscari të Venecias, gjuha shqipe ka zënë një vend të qëndrueshëm brenda programeve të studimit që prej vitit 2002, kur ajo u integrua në kurrikulë së bashku me lëndët e letërsisë dhe të kulturës shqiptare. Futja e saj në këtë institucion të njohur për traditën e gjatë në studimet gjuhësore ka ndihmuar në afirmimin e shqipes si një gjuhë me peshë në panoramën akademike italiane. Ca' Foscari njihet gjerësisht si një nga qendrat më prestigjioze në Itali për studimet ndërkulturore dhe gjuhësore, duke ofruar programe në më shumë se dyzet gjuhë nga kontinente të ndryshme, përfshirë gjuhët aziatike, afrikane dhe të Evropës Lindore.

Në këtë kontekst shumëgjuhësor, shqipja ofrohet si gjuhë e huaj si në ciklin Bachelor, ashtu edhe në Master, duke i dhënë studentëve mundësinë të thellohen jo vetëm në mësimin e gjuhës, por edhe në letërsinë, kulturën dhe historinë shqiptare. Përveç kësaj, katedra e shqipes ka zhvilluar një bashkëpunim të ngushtë me Universitetin e Prishtinës dhe me Universitetin e Tiranës në kuadër të programit Erasmus+. Ky bashkëpunim ndërkombëtar përfshin shkëmbime të rregullta të studiuesve dhe të studentëve nga Shqipëria, nga Kosova dhe nga Italia, duke krijuar një platformë të pasur për dialog akademik dhe kulturor, si dhe për përhapjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare në një kontekst ndërkombëtar.

Katedra e Gjuhës Shqipe në Universitetin Ca' Foscari të Venecias ka arritur të afirmohet si një qendër e rëndësishme studimore në fushën e albanologjisë, duke dhënë një kontribut të vazhdueshëm në kërkimet mbi gjuhën, mbi letërsinë dhe mbi kulturën shqiptare. Përmes një qasjeje të integruar, ajo ka zgjeruar ndjeshëm hapësirën akademike kushtuar shqipes, si në rolin e saj si gjuhë e huaj, ashtu edhe në dimensionin e saj si gjuhë e trashëgimisë. Ndër veprimtaritë më të rëndësishme të kësaj katedre përfshihet hartimi i materialeve didaktike të dedikuara për studentët që nisin kontaktin e tyre të parë me gjuhën shqipe, duke u ofruar mjete moderne për të përvetësuar strukturën dhe përdorimin e saj. Në të njëjtën kohë, katedra ka zhvilluar kërkime të thelluara mbi variacionin gjuhësor, duke shqyrtuar marrëdhëniet komplekse mes dialekteve dhe

standardit, një temë veçanërisht e rëndësishme për brezat e dytë dhe të tretë të emigrantëve shqiptarë që rriten në mjedise shumëgjuhëshe dhe që shpesh njohin vetëm një variant dialektor të gjuhës së tyre amtare. Përmes studimeve dhe analizave të tyre, profesorët e Ca' Foscari-t kanë ndriçuar vështirësitë dhe sfidat që këta të rinj hasin gjatë përvetësimit të normës standarde, duke marrë kështu një rol të rëndësishëm në kuptimin e dinamikave bashkëkohore të gjuhës shqipe. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i punës së katedrës lidhet me organizimin e konferencave, të seminareve dhe të takimeve ndërkombëtare, të cilat shërbejnë si hapësira të vërteta dialogu mes studiuesve të fushave të ndryshme.

Në Universitetin Ca' Foscari, gjuha shqipe ofrohet në dy drejtime kryesore: si gjuhë e huaj për studentët që nuk kanë lidhje me komunitetin shqiptar dhe si gjuhë e trashëgimisë për ata që vijnë nga familje shqiptare. Në kuptimin e parë, shqipja trajtohet si çdo gjuhë tjetër e huaj e studiuar në një mjedis ku ajo nuk përdoret në jetën e përditshme; kështu, në Itali ajo konsiderohet gjuhë e huaj dhe u mësohet studentëve nga një lektor që është folës amtar. Ky grup përfshin të gjithë studentët joshqiptarë ose ata që, pavarësisht prejardhjes, nuk kanë pasur kontakt të drejtpërdrejtë me gjuhën në familje. Ndërkohë, për studentët me origjinë shqiptare, shqipja merr një dimension tjetër: ajo funksionon si gjuhë e trashëgimisë, e ruajtur dhe transmetuar përmes familjes dhe komunitetit. Kjo kategori përfshin kryesisht të rinjtë e brezit të dytë, të lindur në Itali ose të ardhur në moshë të njomë, të cilët janë rritur në një mjedis ku italishtja është gjuha dominuese. Përkundër faktit se këta të rinj zotërojnë një italishte të rrjedhshme dhe të natyrshme, përdorimi i shqipes për ta shpesh mbetet i kufizuar. Ata e kanë përvetësuar shqipen si gjuhë të dytë, zakonisht në kontekste familjare, ndaj ndeshen me mangësi në fjalor, në strukturat gramatikore ose në rrjedhshmërinë e të folurit, sidomos nëse gjuha nuk është përdorur rregullisht gjatë rritjes së tyre. Ky dallim mes shqipes si gjuhë e huaj dhe si gjuhë e trashëgimisë është thelbësor për të kuptuar nevojat e ndryshme të studentëve dhe për të orientuar qasjet pedagogjike që Universiteti Ca' Foscari ndjek në mësimdhënien e saj.

Për shumë të rinj të brezit të dytë me origjinë shqiptare, shqipja nuk përbën gjuhën e parë të komunikimit. Duke qenë se ata kanë lindur ose janë rritur në Itali, italishtja bëhet natyrshëm gjuha e mjedisit ku jetojnë, mësojnë dhe ndërveprojnë çdo ditë. Në këto kushte, shqipja mbetet kryesisht një gjuhë e përdorur brenda familjes ose në raste të veçanta

që lidhet me komunitetin e origjinës, pa pasur të njëjtën peshë në jetën sociale apo profesionale të tyre. Si pasojë, kompetenca e tyre në shqip është shpesh më e kufizuar. Shumë prej këtyre të rinjve e përdorin gjuhën amtare në mënyrë të pjesshme, duke pasur fjalor të reduktuar, vështirësi në strukturat gramatikore ose mungesë rrjedhshmërie. Në praktikë, italishtja mbetet mjete kryesor i komunikimit, ndërsa shqipja funksionon si një gjuhë e dytë që nuk është gjithmonë e pranishme në të gjitha sferat e jetës së tyre të përditshme.

Kur shqipja mësohet si gjuhë e trashëgimisë, studentët zakonisht hyjnë në procesin e mësimin me një bazë gjuhësore tashmë të formuar. Aftësitë e tyre nuk burojnë nga ekspozimi ndaj një mësimdhënieje formale, por nga kontakti i vazhdueshëm me familjen dhe me komunitetin shqiptar. Për këtë arsye, ata janë të njohur me sistemin tingullor të shqipes dhe zotërojnë një leksik elementar, edhe pse shpesh mungojnë fjalët dhe shprehjet që i përkasin niveleve më të avancuara të gjuhës. Në mënyrë intuitive, këta studentë kanë përvetësuar disa prej rregullave bazë të morfologjisë, si përputhjen e emrit me mbiemrin ose përdorimin e formave të lakimit në situatat më të zakonshme të komunikimit. Po kështu, ata janë njohur me parimet themelore të zgjedhimit të foljeve dhe me strukturat sintaksore që u lejojnë të ndërtojnë fjali të thjeshta dhe të natyrshme. Megjithatë, ata shpesh ndiejnë nevojën për mbështetje shtesë kur bëhet fjalë për përdorimin e formave më të ndërlikuara gramatikore, zgjerimin e fjalorit dhe shprehjen e ideve abstrakte apo akademike.

Megjithatë, për shumë studentë të brezit të dytë, njohja e shqipes mbështetet kryesisht në përvojën gojore dhe në përdorimin praktik të saj, pa një ndërgjegjësim të plotë për sistemin e saj të brendshëm gramatikor. Ata zakonisht komunikojnë mirë në situata të përditshme, por nuk janë të familjarizuar me rregullat dhe nocionet teorike të gjuhës, siç janë pesë rasat e shqipes, elementet e ndryshueshme të gjuhës, ose konceptet gramatikore si parafjalët, ndajfoljet, dhe përemrat klitikë. Po ashtu, njohuritë për kohët dhe mënyrat e foljes janë shpesh të kufizuara, pasi përdorimi i tyre bazohet në intuitë dhe në mësimin informal që kanë marrë brenda familjes, dhe jo në njohje të strukturuar të normave morfologjike e sintaksore. Gjuha që ata përdorin është zakonisht një variant dialektor, i lidhur ngushtë me praktikën komunikative të shtëpisë dhe të komunitetit. Kjo formë e shqipes, edhe pse funksionale në kontekste të përditshme, nuk mbështetet te standardi, çka ndikon drejtpërdrejt në aftësitë e tyre të shkruarit dhe të lexuarit. Shumë

prej këtyre të rinjve kanë kompetencë kryesisht orale, ndërsa leximi dhe shkrimi mbeten fusha ku ndihen më të pasigurt. Kur përpiqen të shkruajnë shqip, gabimet janë të shpeshta dhe pasqyrojnë jo vetëm mungesën e ekspozimit ndaj formës së shkruar të gjuhës, por edhe njohuritë e pjesshme për strukturat gramatikore. Për ta, shkrimi në shqip shpesh shndërrohet në një detyrë të vështirë, sepse kërkon një kontroll më të thelluar të normave gjuhësore dhe të aftësive që nuk zhvillohen natyrshëm në mjedise ku gjuha përdoret vetëm në formën e saj të folur.

Pothuajse asnjëri prej studentëve nuk ka njohuri të thella mbi standardin e gjuhës shqipe. Për shembull, ata shpesh përdorin formën njëjës të trajtës së shkurtër të përemrit dhanor *i* në vend të formës standarde *u*, duke ndërtuar fjali si: *i dhashë librat studentëve* dhe jo *u dhashë librat studentëve* ose nuk njohin dot mbiemrin pronor *sime* dhe ndërtojnë fjali si *libri i vajzës time* dhe jo *libri i vajzës sime* ose fjali si *libri i shoqes tonë* në vend të *libri i shoqes sonë/ libri i shoqes tuaj* në vend të *libri i shoqes suaj*.

Në këtë kuptim, studentët e brezit të dytë nuk i qasen universitetit për të nisur nga fillimi mësimin e shqipes, por për të ndërtuar mbi atë që tashmë dinë, duke përmirësuar elementet gramatikore dhe duke strukturuar më mirë kompetencën e tyre gjuhësore. Në auditor, ata zbulojnë se mënyra e të folurit që kanë praktikuar në familje është vetëm një prej varianteve të shqipes dhe se kjo formë mund të vendoset në raport të natyrshëm me standardin. Ky proces u jep mundësinë të kuptojnë karakteristikat që dallojnë dialektin nga varianti standard dhe të ndërtojnë ura mes tyre. Falë kësaj qasjeje, studentët fitojnë një vetëdije më të madhe gjuhësore: ata njohin rregullat dhe strukturat që përbëjnë gjuhën standarde dhe mësojnë t'i përdorin ato me kompetencë në kontekste të ndryshme. Kështu, kalimi nga përdorimi i një forme dialektore drejt standardit bëhet më i qëndrueshëm dhe më i natyrshëm, duke i pajisur studentët me aftësitë e nevojshme për të përdorur shqipen në mënyrë të saktë, të vetëdijshme dhe funksionale si në komunikimin akademik, ashtu edhe në atë profesional.

Qëllimi kryesor i universitetit është t'i ndihmojë këta studentë të përmirësojnë gjuhën që përdorin, e cila shpesh është e papërsosur, dhe t'i drejtojë ata drejt shqipes letrare, të standardizuar dhe asaj të gramatikës (për t'i bërë ata të mësojnë se *me punu* është dialektore dhe jo letrare, se *i dhashë librat atyre* është e gjuhës së folur dhe jo e gjuhës së shkruar). Objektivi i universitetit është të sigurojë që strukturat gjuhësore të këtyre studentëve të mos mbushen me forma dialektore dhe format dialektore

të mos ndërhyjnë në strukturat e gjuhës letrare. Shkurt, ata në universitet perfeksionojnë njohuritë dhe zotërimin e një gjuhe që tashmë e flasin dhe mësojnë se disa dukuri gjuhësore që lidhen me morfologjinë, sintaksën dhe leksikun janë standarde/letrare. Fakti që në Shqipëri gjuha shqipe letrare është mjeti komunikues nëpërmjet të cilit realizohet arsimi shkollor, në formë gojore dhe të shkruar, dëshmon se ekziston një model 'korrekt' dhe me këtë model duhet të bëhet krahasimi. Dhe kjo duhet t'u mësohet folësve të gjuhës së trashëgimisë.

Nga ana tjetër, është gjithashtu e vërtetë se gjuha ndryshon me kalimin e kohës, ndryshon në hapësirë, ndryshon sipas grupeve shoqërore (sipas moshës, gjinisë, profesionit, nivelit arsimor), ndryshon sipas regjistrit (formal ose informal), sipas situatës komunikuese, sipas llojit të tekstit. Dhe kjo na shtyn të bëjmë pyetjen: cili është modeli referues për mësimdhënien e shqipes? Nuk mund t'u transmetojmë studentëve një gramatikë dhe një gjuhë abstrakte. Ata duhet të mësojnë një gjuhë që përshtatet me eksperiencën komunikuese, sepse përmirësimi i shqipes standarde, i gramatikës letrare mund të jetë i pamjaftueshëm në kontekstet shoqërore joformale, aty ku përdoret gjuha e gjallë. Pra, duhet toleruar klitiku njëjës i dhanores, *i* në vend të shumësit *u*, në fjali si *i dhashë librat studentëve*, duhen toleruar trajta si *shoqes tonë* në vend të *shoqes sonë*, ose forma si *shoqes tuaj* në vend të *shoqes suaj*.

Në Ca' Foscari përpigemi t'u shpjegojmë studentëve etnikë se ekzistojnë lloje të ndryshme variacionesh gjuhësore; përpigemi t'u shpjegojmë se dialekti i tyre është një nga varietetet e mundshme; t'u sigurojmë atyre një metodologji krahasuese me modelin standard dhe të aktivizojmë te këta studente strategji që i shtyjnë nga dialekti i origjinës në gjuhën standarde. Në këtë proces, nuk nisemi nga zero. Përkundrazi, mbështetemi në përvojën dhe kompetencat që studentët kanë fituar natyrshëm gjatë viteve, duke i angazhuar në aktivitete që i nxisin të reflektojnë mbi përdorimin e gjuhës. Përmes ushtrimeve të synuara, ata fillojnë të pyesin veten se çfarë është një variant gjuhësor, si është ndërtuar standardi dhe cilat rregulla e përcaktojnë gjuhën letrare. Qëllimi është t'u japim atyre mjetet për të kaluar me vetëdije dhe siguri nga dialekti i tyre i origjinës drejt shqipes standarde, duke zhvilluar një kompetencë të dyfishtë që u mundëson të lëvizin lirshëm mes dy regjistrave gjuhësorë.

Në përfundim, është e rëndësishme të theksohet se në Universitetin Ca' Foscari, nuk mësohet vetëm gjuha shqipe, por edhe letërsia dhe

kultura shqiptare. Gjuha është një shprehje e drejtpërdrejtë e kulturës dhe një mjet i fuqishëm për ruajtjen dhe përcjelljen e identitetit kulturor. Studentët me origjinë shqiptare në Venecia nuk janë thjesht bilingualë, por edhe bikulturorë, pasi ata u përkasin njëkohësisht një grupi të huaj, si gjuhësor, ashtu edhe kulturor. Kjo dygjuhësi dhe dykulturorësi i vendos studentët në një pozicion të veçantë: ata ndërthurin elementet e kulturës shqiptare me ato të kulturës italiane, duke krijuar një identitet të pasur dhe kompleks. Çdo popull ka një model unik të kulturës dhe qytetërimit, dhe shqiptarët nuk bëjnë përjashtim. Vlerat, traditat dhe sjelljet e përbashkëta të shqiptarëve pasqyrojnë një trashëgimi të veçantë kulturore, që studentët kanë mundësinë ta njohin dhe ta ruajnë përmes studimeve të tyre në Ca' Foscari. Ky proces përforcon lidhjen e tyre me identitetin kombëtar, ndërsa i ndihmon të integrohen në mënyrë harmonike në shoqërinë italiane.

Ideologjia kombëtare e diasporës shqiptare përçon një mesazh të fortë ndaj brezave të rinj: ruajtja e gjuhës dhe kulturës së origjinës është një akt themelor për mbajtjen gjallë të identitetit kombëtar në emigracion. Humbja e gjuhës nuk shihet vetëm si humbje e një mjeti komunikimi, por interpretohet si shuarje e kujtesës kolektive dhe mohim i trashëgimisë shpirtërore dhe historike të paraardhësve. Në kontekstin italian, gjuha shqipe dhe kultura shqiptare vazhdojnë të mbijetojnë dhe të lulëzojnë, falë përpjekjeve të ndryshme individuale dhe kolektive. Universiteti Ca' Foscari në Venecia luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, duke ofruar mundësi studimi për studentët shqiptarë dhe për ata italianë që dëshirojnë të njohin më thellë këtë trashëgimi gjuhësore dhe kulturore.

Përfundime

Marrëdhënia mes shqiptarëve dhe Venecias nuk mbetet vetëm një kapitull i së shkuarës së largët, por një proces që vijon të ripërkufizohet në kohë. Historitë e hershme të migrimit, institucionet komunitare dhe prania e sotme e diasporës krijojnë një vijimësi që dëshmon aftësinë e këtij komuniteti për të ruajtur identitetin, duke u përshtatur njëkohësisht me një realitet të ri shoqëror e kulturor. Në këtë kuadër, gjuha shqipe shfaqet si elementi më i brishtë, por edhe më i rëndësishmi për mbijetesën e kujtesës kolektive. Mësimi i saj në shkolla, në komunitet dhe në universitet – sidomos në Ca' Foscari – dëshmon se ruajtja e gjuhës nuk ndodh vetvetiu,

por kërkon ndërgjegjësim, përkushtim dhe mbështetje institucionale. Përvoja e studentëve të brezit të dytë tregon se identiteti gjuhësor nuk është i pandryshueshëm: ai mund të forcohet, të zbehet ose të rimëkëmbet, në varësi të mënyrës se si trajtohet. Prandaj, ruajtja e shqipes në Itali duhet parë jo vetëm si çështje didaktike, por si një proces i gjerë kulturor që kërkon vëmendje të vazhdueshme, bashkëpunim dhe politika më të hapura ndaj gjuhëve të emigracionit.

Literaturë

Nadin, Lucia. *Migrazioni e integrazione: il caso degli albanesi a Venezia, 1479-1552*. Bulzoni Editore, 2008.

Montrul, Silvina. *The acquisition of heritage languages*. Cambridge University Press, 2016.

Polinsky, Maria. *Heritage Languages and Their Speakers*. Cambridge: Cambridge University Press, 2018.

Aitchison, Jean. *Language Change: Progress or Decay?* Cambridge: Cambridge University Press, 2013.

Repubblica Italiana. *Costituzione della Repubblica Italiana*. Neni 6. Legge 15 dicembre 1999, n. 482. *Norme in materia di tutela delle minoranze linguistiche storiche*.

Decreto Legislativo 25 luglio 1998, n. 286. *Testo unico delle disposizioni concernenti la disciplina dell'immigrazione e norme sulla condizione dello straniero*.

Circolare Ministeriale n. 73/1994. *Educazione interculturale nelle scuole italiane*.